



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 12 060-15884 dt. 20.05 2020

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Labinot Halilaj, më datë: 27/05/2020 (e Mërkure) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 30.04.2020.
2. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të ngastrave kadastrave, në të cilat ndodhen burimi i ujit të pijes dhe rezervari i ujit ku ndodhet edhe objekti në të cilin janë të vendosura edhe pompat.
3. Raportimi i Kryetarit për pjesën e mjeteve financiare të shpenzuara për menaxhimin e situatës nga COVID -19.
4. Propozim Vendim për rritjen dhe bartjen të hyrave vetanake nga viti 2019 në vitin 2020, me ndryshime.
5. Të ndryshme.

Drenas, 20.05.2020




Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Labinot Halilaj



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



12 Nr. 080-15873 dt. 20.05 2020

**Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
30. 04.2020**

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: 28.02.2020

Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 30 anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 28.02.2020.
2. Propozim Vendim për lirim nga taksa Komunale për bizneset që operojnë në Komunën e Drenasit për vitin 2020.
3. Propozim Vendim i statutit për ndërmarrjen publike Lokale “Stacioni i autobusëve” , SH. A. në Drenas-Glllogoc.
4. Propozim Vendim për formimin e komisionit për vlerësimin e pronave që mund të këmbehen dhe dhënie e rekomandimeve për pronat që duhet të shpronësohen në parcelën 743/1,në zonën e kadastrave Drenas.
5. Diskutim rreth situatës emergjente e krijuar nga COVID-19, dhe mundësit e ndarjes buxhetore për tejkalim të situatës në Komunën e Drenasit.
6. Draft propozim për ndryshim-plotësimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024.
7. Propozim Vendim për rritjen dhe bartjen të hyrave vetanake nga viti 2019 në vitin 2020.
8. Raporti Financiar i zhvillimit të Buxhetit Janar-Mars 2020.
9. Të ndryshme.

Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të datës 30 /04/ 2020 ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj, si dhe drejtorët e Drejtorive përkatëse.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj: pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, me rastin e rënies heroike të komandantit **Ilaz Kodra**, viktimave Verboc, Shtuticë dhe për të gjithë të rënët gjatë këti muaji, ftoi të gjithë për një minutë nderim.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj: besoj se të gjithë jeni të informuar me materialin lidhur për këtë seancë, para se me shku ne votim për këtë rend dite, a ka dikush diçka, po fjala e kryetarit të Komunës **Ramiz Lladrovci**.

Kryetari Ramiz Lladrovci: përshëndeti të gjithë të pranishmit si dhe falënderoi të gjithë qytetaret e komunës Drenasit për gjithë respektin ndaj pandemisë që po e bëjnë sepse siç e dimë te gjithë ne nuk jemi vatër as nuk kemi qene vatër e infeksionit sepse zoja nga Zabeli nuk ka qenë e infektum asnjëherë domethan është bërë një gabim në mostra apo vetë mostra ka qenë me defekt kështu që tash është vërtetu, ndërsa zyrtari i Ministrisë së Shëndetësisë ka qenë i infektum në punë dhe nuk ka pas as një kontakt me qytetarët tan edhe aty po dyshonim sepse njëqind e pesëdhjetë zyrtar tjerë që kanë punua bashkë me ta asnjë nuk janë dalë pozitiv përveç atina dhe aty po dyshoim, jo që po dyshoim te stafi se i gjithë stafi është i specializum po te mostra te rezultati i cili se edhe në Gjermani, Itali, Spanjë gjithkund po jep rezultate të gabueshme thamë që nuk është faji i njerëzve.

Për shkak të gjendjes që e kemi na nuk kemi mujtë me mbajt mbledhje të Kuvendit dhe e kemi përdor mbledhjen që e kemi mbajt dhe pikat e rendit të ditës që janë vendos në mbledhjen e KPF dhe na për këtë mbledhje i kemi propozua dhe katër pika të rendit të ditës dhe nëse ka dikush edhe najë pikë tjetër ne mund ta shtojmë dhe unë propozoi:

1. Draft propozim për ndryshim-plotësimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024. Si vendim është bërë por për shkak se ne duhet me ndërrua se është trevjeçar dhe duhet me bërë katër vjeçar.
2. Propozim Vendim për rritjen dhe bartjen të hyrave vetanake nga viti 2019 në vitin 2020.
3. Raporti Financiar i zhvillimit të Buxhetit Janar-Mars 2020.
4. Propozim Vendim për lirim nga taksa Komunale për bizneset që operojnë në Komunën e Drenasit për vitin 2020.

Pra ne kërkojmë nga ju sot ti lirojmë të gjitha bizneset prej taksës vetëm për këtë vit 2020, pra jo edhe për vite tjera. Pra ata që kanë borxhe sepse janë në proces gjyqësor apo te përmbaruesi .

Këto janë katër pika dhe unë ju ftoi me i votua, nëse ka dhe dikush unë jam dakord dhe për pika tjera, ose nëse mendoni se prej këtyre pikave ndonjëra prej këtyre pikave duhet me ndryshu radhitjen ne e ndryshoim.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj: faleminderit kryetar na përveç pikave kemi dhe këto katër propozime ku për këto katër pika të propozuara të rendit të ditës ja kemi përcjell materialet përmes emailav dhe i kanë përpara dhe kopjet fizike.

Kështu që nëse ka dikush rreth rendit të ditës me marrë fjalën, po zoti Berisha.

Vehbi Berisha përshëndeti të pranishmit, faktikisht në e dimë dhe ju mirëkuptojmë që jemi në një situatë që edhe stafi i komunës është me kapacitet të limitum po ju mirëkuptojmë kësaj radhe, po ju kryesues e dini të paktën u bë praktikë se gjysma e materialit po na plotësohet në sallë edhe ne po na duhet pak kohë me u përgatit, qokej në rregull kësaj radhe me sa pe shoh vetëm dy prej pikave me sa u përmenden është ma urgjente, ndërsa me sa po e shef njëra prej pikave kjo për lirim nga taksa është ma urgjente me u trajtua e para pasi që kryetari paska agjendë tutje.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj: faleminderit zoti Berisha veç edhe një sqarim materiali për katër pikat e rendit të ditës një javë përpara ju kemi përcjellë përmes imellës pavarësisht materialit që e keni përpara, vetëm eventualisht nëse se keni hapë imellën, ne nuk kemi dashtë mi fut si pika të rendit të ditës pa koordinim me juve.

Kryesuesi: urdhëro Kryetar;

Ramiz Lladrovci; Vehbi nuk mund të fus pika të rendit të ditës me javë dërgua juve pa kalu në KPF-ca, pra kanë kalu pesë pika tjera e këto janë pika shtesë, njëzet pika me mu tek, njëzet pika i fus në qoftë se kam vota pa ju dërgua asnjë material përpara, ma lejon rregullorja me vjen keq që po thamë kështu për ata e kemi lanë datën 30, për me respektua afatin se sot kemi shumë ngjarje tjera. Po e keni edhe një material për të gjitha donacionet dhe ndihmat e Komunës që kanë ardhë përmes Komunës i keni të dhënat edhe për materialet nga Ministria e Shëndetësisë për masat mbrojtëse që kanë ardhë për situatën Covid- 19.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj: ka dikush tjetër përveç zotit Berisha po urdhëro zoti Kiqina.

Beçir Kiqina faleminderit Kryesues dhe ju të pranishëm, vetëm kisha dashtë mu pajtua me zotin Berisha, i cili e mbështeti piken e kryetarit që e futi në rend dite piken për lirim nga taksa për bizneset në Komunën tonë.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj: ju lutem së pari shikoni procesverbalin se është çështje administrative pastaj shkoim me pikat tjera me radhë.

Hedhim në votim rendin e ditës edhe me katër pika shtesë. Atëherë rendi i ditës miratohet në mënyrë unanime, kundër s'ka abstenim s'ka.

Kalojmë tek pika e parë; 1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 28.02.2020. Ju ftoj për diskutim, nëse s'ka vërejtje apo sugjerime, e hedhim në votim. Në mënyrë unanime u votua dhe procesverbali *kundër s'ka Abstenim s'ka.*

Kalojmë tek pika e dytë; 2. Propozim Vendimi për lirim nga taksa Komunale për bizneset që operojnë në Komunën e Drenasit për vitin 2020.

Fjalën e merr drejtoresha e Drejtorisë për zhvillim Ekonomik Egzona Jetullahu

Egzona Jetullahu; për sqarim të vendimit, faleminderit Kryesues; Duke pasur parasysh situatën e krijuar pas shfaqjes së virusit COVID-19, vendimit Nr. 01/11, të datës 15.03.2020, për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, Vendimeve dhe Urdhëresave të Ministrive përkatëse lidhur me masat për parandalimin e virusit, rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHP) dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) për ndërmarrjen e masave për parandalimin e pandemisë, kërkohet lirim nga pagesa e taksës komunale për të gjitha bizneset që operojnë në Komunën e Drenasit për vitin fiskal 2020, të cilat biznese janë të përfshira në nenin 13 të Rregullores Nr. 12-030-19516, të datës 06.04.2018 për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba.

E gjithë kjo duke pasur parasysh vështësitë financiare të bizneseve për të ushtruar veprimtarinë e tyre ekonomike në këtë gjendje të pandemisë.

Ne jemi të interesuar që bizneset në Komunën e Drenasit që ti ndihmojmë duke ju lehtësuar detyrat e tyre në zhvillimin e veprimtarisë përmes rrjedhjes së kësaj takse së paku për vitin 2020. Ashtu siç e cekim dhe Kryetari Lladrovci duhet të cekim se mjetet e akumuluar prej vitit 2001 e tutje pothuajse janë afër (2.000 000) dy milion euro, të cilat janë të akumuluar të viteve paraprake. Në shumicën e këtyre lëndëve janë duke u përgatitur për procedura përmbarese të cilat presim që në vitet në vijim ti akumulojmë këto të hyra ne i kemi propozuar që së paku në vitin 2020, me miratimin e juaj të hiqet taksa së paku për vitin 2020, për lirim nga taksa.

Kisha pas me shtuar se në qoftë se i marrim të dhënat në Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba duke u bazuar në rregulloren Komunale pothuajse për vitin 2020, të hyra vetanake po humbim 403 600 € që do të thotë është një shumë e madhe për tu shfrytëzuar për ndonjë projekt. Duke marrë parasysh se vitin paraprak ne i kemi afruar afër, 200 000 euro.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj; fjalën e ka Vehbi Berisha.

Vehbi Berisha; Fillimisht e përshëndes këtë propozim të Kryetarit, i cili si institucion komunal e kemi shprehur sadopak solidarizimin tonë ndaj bizneseve për gjendjen që ata e kanë. Mirëpo edhe pse në kohë pandemie propozimi jem personal, e di që po humbi vota, po në këtë kohë pandemie nuk mund të rri pa reaguar për shkak se në taksim janë përfshirë edhe institucione dhe firma private që edhe gjatë kohës së pandemisë kanë punuar gjithë kohës dhe kanë ushtruar

afarizmin e tyre ekonomik, prandaj për mendimin tim personalisht ne nuk guxojmë të përfshijmë si ata që kanë punuar edhe atë që nuk ka punuar. Unë kam ankesa kur edhe pse nuk kane punuar qiraxhija ja ka marre paranë. Mendo që të përfshij edhe barnatoret që kur nuk u ndalen dhe të gjithë e dimë se i kane ngritur edhe çmimet dhe të trajtohen njëllë me të tjerët që nuk kane punuar kjo është e padrejte.

Propozimi im është që të gjitha ato biznese që kanë operuar gjatë pandemisë të hiqen nga ky propozim vendim. Ka biznese që janë sjellë shumë keq me punëtorët duke i kërcënuar se ka punëtoresh plot tani nda q puno nda q lere. Vete kryetari i ka përmendur se ka biznese që nuk kanë zbatuar as urdhëresat e qeverise. Unë nuk dua atë mendoj se po marr poena por që të gjithë duhet në këtë formë ta mendojmë. Prandaj mendoj që propozimi im për ato biznese që kane punuar gjithë kohës si barnatoret, supermarketet dhe minimarketet etj.

Te hiqen nga trajtimi.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj; Faleminderit fjala për kryetarin.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovc; Vehbi, taksa nuk është a ke punua një muaj gjashtë muaj apo nënte muaj, po është takse vjetore. Me rregullore, me ligj, unë të taksoj sikur ke punuar 365 ditë. Të hyrat i duhen komunës për të zhvilluar projekte. Niveli qendror realisht i ka heq disa taksa dhe po jep edhe paketa ndihmëse për bizneset dhe qytetaret, bile edhe pa i kaluar ligjërisht në parlament. Unë nuk mund me kërkua më e shtu dikën dhe me heq dikën. Cilin biznes doni me marrë shembull, doni Ferronikelin. Ferronikeli ka shpenzime shtesë dhe ka zbatuar të gjitha udhëzimet e qeverise dhe për këtë ka shtuar edhe një autobus tjetër për të zbatuar rregullat e pandemisë. Ka mbajtur 1300 familje gjallë. E kam çuar inspektoratin pothuajse çdo ditë dhe ka zbatuar të gjitha rregullat e vendosur nga shteti. Po kështu edhe për farmacitë apo pikat e karburanteve edhe bankat dhe posta ka punua. Është në dorën tuaj që ta miratonin heqjen e taksës ose jo.

Petrit Sinani Po besoj se edhe kolegët e tjerë po bashkohen me këtë propozim, mirëpo unë desha me diskutua disa gjëra. Porsa i përket propozimit të Vehbiu unë kam thënë edhe herët e kalume se tek bizneset nuk duhet të veprohet në mënyrë selektive. Ne e kemi pa se disa biznese kanë punuar gjatë pandemisë dhe duhet të kishim përmendur vërtetë Ferronikelin se është biznesi me i madh dhe normalisht që marrim më shumë taksa nga ky biznes. Barnatoret, Posta, Bankat janë biznese që kanë punuar normalisht dhe kane përfituar donacione nga shteti. Sa i përket qirave të bizneseve, normal që duhen paguar se edhe me vendim të qeverisë është që të paguhen. Unë e kuptoj që kemi edhe shumë informalitet, mirëpo edhe kur e kemi diskutuar, kemi ulur taksat gjatë kohës së pandemisë. Bizneset në përgjithësi do të përfitojnë dhe se ajo që po konsiderohet selektive mendoj se është e gabuar.

Petrit Gashi ; Nuk dua të zgjatëm vetëm desha të dija tarracat dhe parkingjet a do paguhen dhe kur të behet vendimi, dhe nëse përfshihen edhe ato është gjithçka në rregull.

Sokol Bylykbashi; E tha edhe kryetari në mbledhjen e Shtabit të Emergjencës që bizneset e vogla do të përftojnë nga zbritja e taksës dhe nga tarifa. Propozimi im është që të merret vendimi për tre muaj me të drejtë shtyrje, kurse ky propozim vendim nuk më duket shumë i arsyeshëm. Këtu duket se njerëzit kanë qef të flasin të ndihmojmë bizneset. Ky propozim vendim që ka ardhur këtu për me i liru të gjitha bizneset nga tatimet për një vit po më duket jo i saktë dhe siç e tha edhe Vehbiu se ka shume biznese që kanë punuar gjatë kohës së pandemisë dhe bile kanë pasur fitime edhe më tepër gjatë pandemisë si pasoje e rritjes së çmimeve sidomos produktet që kanë pasur të bëjnë me higjienën. Kryetari na qenka i shqetësuar se Barnatoret paskan harxhuar shumë. Unë mendoj kryetar se bizneset duhen mu liru e duhen përkrahur si në nivel qendror edhe në nivel kombëtar, por duhet gjendur një kompromis. Unë mendoj që deri tek numri 19 të lirohen vetëm tre muaj nga tatimet mars, prill dhe maj.

Kryetari; Sokol nuk kemi të drejtë me rregullore të bëjmë lirim selektiv një muaj apo gjashtë muaj. Është në dorën tuaj ta bëni lirimin apo jo.

Beçir Kiqina; Unë mendoj se ky propozim vendim është vendim i drejtë i Kuvendit për ta vendosur këtë taksë dhe mos ta zgjatim më tej, se ngarkohet Komuna. Është dashur të mendohet mire edhe për disa biznese afariste që e kryejnë aktivitetin e tyre në Drenas. Le të interesohemi edhe në institucionet qendrore për tu sqaruar më mirë sepse këto biznese do të vazhdojnë të humbasin edhe me tej.

Adem Bucolli; Unë e përshëndes Sokolin për iniciativën për lirimin nga taksa të bizneseve dhe nuk e kuptoj pse po përdoret tani selektimi. Këto biznese që kanë punuar gjatë kohës, kanë qenë të detyruara edhe nga shteti sepse kanë qenë në shërbim të qytetareve. Nëse nuk do punonin maketet dhe barnatoret, me siguri qytetaret ia kishin thyer lokalet, sepse kanë nevojë për këto shërbime.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj; Atëherë meqë s'ka diskutime kalojmë në votim;

Për 27

Kundër 1

Abstenime 3 Miratohet.

Kalojmë tek pika e tretë; **3. Propozim Vendim i statutit për ndërmarrjen publike Lokale “Stacioni i autobusëve” , SH. A. në Drenas-Glllogoc.**

Sqarim zoti Gashi; Si përfaqësues i Asamblesë së Kuvendit Komunal me është dhënë besimi për të qenë pjese, anëtar i Komisionit për Hartimin e Rregullores për Ndërmarrjet Publike, “Stacioni i Autobusit”. Për të qenë pjesë e rendit të ditës nuk jam dakord, pasi kjo është bërë pa

qenë unë pjesëmarrës në votim, kështu që unë nuk do ta mbështesë kalimin e kësaj pike. Pra i njoftoj gjithë asamblastët se unë nuk kam qenë pjesë e votimit të kësaj rregullore.

Petrë Sinani; Jam mundu me e lexu këtë rregullore dhe personalisht kam disa vërejtje. Statuti i kësaj ndërmarrje nuk është e mbështetur fare në baza ligjore ashtu siç ndërtohen të gjitha statutet mbi bazën e një standardi juridik, të mbështetura në ligje dhe nene të caktuara.

Kështu tek neni 3, thuhet tek Selia Qendrore, sikur do të kemi disa Seli, realisht duhet vetëm Selia, pasi konsideroj se nuk ka seli të tjera, pasi ne jemi komune e vogël. Po këtui, tek neni 3 kemi një përzierje, ku thotë se shenja njohëse ose emblema mund të ndërrohet më vonë dhe të dizajnohet nga drejtorët e bordit. Unë mendoj se vula dhe emblema duhet të përcaktohen me nene të veçanta në statut. Mendoj se është një statut i punuar mirë por duhen marrë parasysh këto vërejtje.

Vehbi Berisha; Këto Ndërmarrjet publike për mendimin tim janë të zorit edhe në komuna të tjera, ndaj duhet vepruar se s'kemi ndryshë, sepse ato po operojnë, dhe se çfarë performançe ekonomike kanë, si ndërmarrje publike po shihet. Pothuajse gjithandej kanë probleme serioze në menaxhimin e tyre dhe po monitorohen nga auditori, por ne jemi të detyruar ti japim një zgjidhje Stacionit të Autobusëve. Edhe unë mendoj, ashtu si Petriti, që emblema të jetë e përcaktuar në statut. Kurse tek neni 2, tek fushëveprimi pika 5 e nenit 2; Ndërmarrja mund të ushtrojë çdo lloje funksioni tregtar dhe financiar i cili lidhet direkt me objektin e saj. Po ashtu duhet sqaruar se çfarë do të bëhet, apo të jetë e sqaruar me bizneset private që janë brenda territorit të kësaj ndërmarrje. A do preken apo jo. Po ashtu edhe për buxhetin, aksionet e shoqërisë të caktohet se sa është vlera ekonomike e aksioneve si edhe vlera e objekteve.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj; Atëherë meqë s'ka diskutime kalojmë në votim
Për 26

Abstenim 2

Kundër 2. Miratohet.

Kalojmë tek pika e katër; **4. Propozim Vendim për formimin e komisionit për vlerësimin e pronave që mund të këmbëhen dhe dhënien e rekomandimeve për pronat që duhet të shpronësohen në parcelën 743/1, në zonën e kadastrave Drenas.**

Ju ftoj për debat fjalën e ka kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci; Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, pika h, të ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-014. Neni 72, të statutit të Komunës së Drenasit, si kryetar i Komunës së Drenasit propozoj; që në bazë të Nenit 12 dhe 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 të gazetës zyrtare të Republikës së Kosovës, neni 34 të Statutit të Komunës Drenasit, Neni 24, të Ligjit nr. 06/L - 092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës,

Neni 4 dhe 7, të Ligjit nr. 03/L-159 për Shpronësimin e Pronave të Palujtëshme në ndryshimet dhe shpronësimet e bëra me Ligj nr. 03/L-205 të datës 28 tetor 2010, Kuvendi i Komunës së Drenasit, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2020 propozoj këtë propozim vendim;

Për formimin e komisionit për vlerësimin e pronave që mund të këmbehen, dhënien e rekomandimeve për pronat që duhen të shpronësohen në parcelën 743/1 në zonën e kadastrave Drenas. Me këtë propozim - vendim të krijohet komisioni për vlerësimin e pronave që mund të këmbehen dhe dhënien e rekomandimeve për pronat që duhen të shpronësohen në parcelën 743/1 në zonën kadastrale Drenas në përbërje prej 5 anëtareve, të cilin komision e përbëjnë 3 anëtarë nga Ekzekutivi i Komunës, të cilët i propozon Kryetari i Komunës dhe 2 anëtar nga Kuvendi i Komunës. Për këtë komision nga ekzekutivi propozoj Granit Karaqica (ndërtimtar), Fadil Tahiri (gjeodet), Granit Hasani.(Jurist)

Arsyetim

Duke pasur parasysh Planin Zhvillimor Komunal, Hartat Zonale dhe Planifikimin Urban në Komunën e Drenasit, me qëllim të realizimit të interesit të përgjithshëm, në zonën kadastrale në Drenas, në parcelën 743/1, do të behët këmbimi, respektivisht shpronësimi i banesave pronë private, të cilat ndodhen në pronën e komunës së Drenasit, duke siguruar edhe qëllimin e përmbushjes së interesit publik dhe zhvillimin ekonomik lokal.

Parcela 743/1, në zonën kadastrale në Drenas, në bazë të Planit Zhvillimor Komunal është zonë e planifikuar për ndërtim të lartë.

Andaj, qëllimi i këtij komisioni është që të bëjë vlerësimin e të gjitha banesave private të cilat ndodhen në pronën komunale, e të cilat mund të këmbehen me banesat pronë komunale, në të njëjtën kohë të epen rekomandimet për banesat private të cilat në bazë të m² nuk mund të këmbehen.

Duke pasur parasysh këto që u thanë me lartë kërkoj nga ana juaj që të aprovoni këtë propozim vendim me qëllim të realizimit të interesit të përgjithshëm në atë zonë.

Gani Podrimqaku; Në emër të grupit parlamentar të PDK-së propozoj Malësore Sakiqi dhe Sabrie Kukaj propozoi Burim Bujupi.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj; Atëherë përfundimisht ju ftoj të votoni përbërjen e këtij Komisioni

Për votuan 27 anëtar

Kundër 1

Abstenim s'ka. Komisioni miratohet.

Vijojmë me pikën e pestë; **5. Diskutim rreth situatës emergjente e krijuar nga COVID-19, dhe mundësitë e ndarjes buxhetore për tejkalim të situatës në Komunën e Drenasit.** Meqë kjo pikë është diskutuar edhe me parë, pa diskutime u miratua me votim unanim

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj Kalojmë tek pika e gjashtë; **6. Draft propozim për ndryshim-plotësimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024.**

Drejtoresha e Drejtorisë për zhvillim Ekonomik, Egzona Jetullahu bëri arsyetimin për draft propozimin për ndryshim-plotësimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal dhe meqë diskutime nuk pati kaloi ne votim dhe u miratua me votim unanim.

Për votuan 27 anëtar

Kundër s'ka

Abstenim s'ka.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj Kalojmë tek pika e gjashtë; **7. Propozim Vendim për rritjen dhe bartjen të hyrave vetanake nga viti 2019 në vitin 2020.**

Fjalën e merr drejtoresha e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik

Egzona Jetullahu; Për sqarim. Buxheti Komunal për vitin 2019, është i planifikuar ne shumen prej: 1.313.535.00 € i financuar nga nga te hyrat vetanake .

Te hyrat vetanake si objektiv per vitin 2019 ka qenë 1.313.535.00 € ku Brenda 12 muajve të vitit aktual janë realizuar me shumë prej: 1,615.977.69 € apo është tejkaluar objekti vjetor prej 123.03% .

- Sektori i përgjithshëm i Administratës ka tejkaluar objektivin e THV prej 123.81 % .
- Sektori i Arsimit ka arkëtuar mjete për 12 muaj prej: 86.01% te objektivit vjetor.
- Derisa Sektori i Shëndetësisë ka arkëtuar mjete prej: 121.05 % te objektivit vjetor.

Çdo euro e anketuara mbi objektivin vjetor për t'u alokuar kërkohet vendim i Kuvendit te Komunës lidhur me rritjen e te hyrave vetanake .

Analizuar sipas realizimit gjatë vitit 2019, kemi tejkaluar planifikimin dhe propozojmë rritjen e te hyrave vetanake ne shume prej: 302.442.69€, rritje kjo, e cila do te rrite totalin vjetor për THV nga : 1,313.535.00 € në 1.615.977.69 €.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj Faleminderit drejtoreshe diskutime s'ka, e kalojmë në votim

Për votuan 27 anëtar

Kundër s'ka

Abstenim s'ka.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj Kalojmë tek pika e shtatë; **8. Raporti Financiar i zhvillimit të Buxhetit Janar-Mars 2020.** Ka diskutime rreth raportit financiar, nuk ka, kalon edhe kjo pikë.


Kalojmë tek pika e nëntë; **9. Të ndryshme.**

Pasi nuk pati diskutime tjera vërejtje apo sugjerime, kryesuesi i Kuvendit Komunal konsideroi si të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 14: 44 min.

Proesmbajtëse:


Zahrie Podrimqaku Subashi





REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Drénasit

Zyra e Kuvendit



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me datë 20.05.2020, si vijon:

-Pasi kryesuesi përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e K.P.F-ca se kemi një pika shtesë në rendin e ditës : Propozim Vendim për rritjen dhe bartjen të hyrave vetanake nga viti 2019 në vitin 2020, me ndryshime për një gabim teknik prej: 0.08 €.

Të gjithë anëtarët e K.P.F-ca u pajtuan që të futen edhe kjo pika shtesë në rendin e ditës, dhe u aprovua në mënyrë unanime nga të gjithë anëtarët rendi i ditës me:

Votuan 06 Për, Kundër: 00, dhe abstenim: 00

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 20.03.2020.

- Votuan 06, vota për, Kundër: 00, dhe abstenim: 00

2. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të ngastrave kadastrave, në të cilat ndodhen burimi i ujit të pijes dhe rezervari i ujit ku ndodhet edhe objekti në të cilin janë të vendosura edhe pompat.

- Votuan 03, vota për, Kundër: 0, dhe abstenim: 3

3. Raportimi i Kryetarit për pjesën e mjeteve financiare të shpenzuara për menaxhimin e situatës nga COVID -19.

Fjalën e mori Burim Bujupi i cili për Kuvend kërkoi të ketë Raport me shkrim për mjetet të cilat janë shpenzuar.

Edhe kjo pikë e rendit të ditës kaloj për Kuvend

4. Propozim Vendim për rritjen dhe bartjen të hyrave vetanake nga viti 2019, në vitin 2020, me ndryshime për një gabim teknik prej: 0.08 €.

- Votuan 06, vota për, Kundër: 00, dhe abstenim: 00

5. Të ndryshme.

Pasi spati diskutime mbledhja përfundoi në ora 10:42.

Kryesuesi i Kuvendit

Labinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E DRENASIT

ZYRA E KRYETARIT

Nr.01-400/01-15356 dt.13.05.2020

Në bazë të nenit 58 par. 1 pika *h* të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72.2 paragrafi (a) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozonë: që në bazë të nenit 12 paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nenit 14 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenit 4 paragrafi 1 pika 1.1 dhe paragrafi 2 pika 2.3, pika 2.4 dhe nënpika 2.4.3 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (Ligji Nr.03/L-139), Kuvendi i Komunës së Gllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2020 të aprovoi këtë:

PROPOZIM -V E N D I M

Për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të ngastrave kadastrale, në të cilat ndodhen burimi i ujit të pijes dhe rezervuari i ujit ku ndodhet edhe objekti në të cilin janë të vendosura edhe pompat .

I.

Të APROVOHET Propozim vendimi për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik për ngastrat kadastrale në Krojkovë, për parcelat të cilat janë prona private, me nr. :

- P-70315035-00207/2,
- P-70315035-00208/4
- P-70315035-00211/4

II.

Qëllimi për shpalljen e këtyre parcelave në interesë të përgjithshëm publik është bërë me qëllim të realizimit të interesit publik të Komunës së Drenasit për projektin e funksionalizimit të sistemit të ujësjellësit, në zonen kadastrale në Krojkovë, te burimi i ujit dhe rezervuari ku ndodhet edhe objekti në të cilin janë edhe pompat, për të furnizuar banorët e Komunës së Drenasit me ujë të pijes, konkretisht për banorët e fshatit Krojkovë.

III.

